



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MARRËVESHJE PËR ORGANIZIMIN E ANKANDEVE TË TITUJVE TË SHTETIT SHQIPTAR, SHLYERJEN E VEPRIMEVE, DHE MBAJTJEN E REGJISTRIT TË KËTYRE TITUJVE

Ndryshuar datë 06.07.2018 nr prot BSh.3632, nr prot MFE 12981

Kreu I Dispozita të përgjithshme

Neni 1 Baza juridike

Marrëveshja lidhet në bazë dhe në zbatim të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave.

Neni 2 Qëllimi

Marrëveshja ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve për:

- a) kryerjen e ankandit të titujve dhe operacionet e Ministrisë në tregun sekondar të titujve;
- b) shlyerjen e transaksioneve që kryhen me këto tituj; dhe
- c) mbajtjen e regjistrit për titujt nga Banka në funksionin e saj si agjent fiskal i Qeverisë të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria.
- d) pjesëmarrjen e Ministrisë në sistemin AFISaR të Bankës ku realizohen veprimet sipas shkronjave òaò, òbö dhe òcö të këtij neni.

Neni 3 Përkufizime

Në zbatim të marrëveshjes, termat e mëposhtëm kanë kuptimin që vijon:

- a) **“Agjent shlyerës”** - është Banka, e cila ofron llogari shlyerje për pjesëmarrësit e sistemeve, nëpërmjet të cilave, pjesëmarrësit shlyejnë urdhërpagesat dhe/ose urdhërtransferrat e titujve;

- b) **“Ankand”** - është ankandi i zhvilluar nga Banka për shitjen e titujve;
- c) **ðAnkand për marrëveshjet e riblerjes** ó është ankand për lidhjen e marrëveshjeve të riblerjes, nëpërmjet të cilave Ministria bie dakord të blejë përkohësisht tituj me synim rishitjen e tyre në datën e përcaktuar për rishitjen e tyre;
- d) **ðAnkand për marrëveshjet e anasjellta të riblerjes** ó është ankand për lidhjen e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes, nëpërmjet të cilave Ministria bie dakord të shesë përkohësisht tituj me synim riblerjen e tyre në datën e përcaktuar për riblerjen e tyre;
- e) **“Autoriteti”** - është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i krijuar me ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 ðPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareó, i ndryshuar;
- f) **“Bankat”** - janë subjektet e licencuara nga Banka sipas ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 ðPër bankat në Republikën e Shqipërisëó, i ndryshuar;
- g) **ðData e emetimit**ó është data nga e cila nis llogaritja e interesit për një titull të shitur nëpërmjet ankandit në tregun primar;
- h) **ðData e maturimit**ó është datë në të cilën paguhet nga Ministria vlera nominale e titullit;
- i) **ðData e shlyerjes**ó është datë në të cilën titujt kalojnë nga llogaria e shitësit tek llogaria e blerësit dhe njëkohësisht fondet kalojnë nga llogaria e blerësit në llogarinë e shitësit; Për transaksionet në tregun primar, data e shlyerjes është data në të cilën njihen detyrimet, iniciohet, mund të përfundojë kalimi i titujve dhe i fondeve në llogaritë respektive;
- j) **“Data e shlyerjes finale”** – është data e përcaktuar në njoftimin e ankandit si data finale për shlyerjen e transaksioneve të gjeneruara nga pjesëmarrja në ankand, pas të cilës ky transaksion anulohet. Data e shlyerjes finale mund të jetë në të njëjtën datë ose pas datës së shlyerje për transaksionet e gjeneruara nga tregu primar;
- k) **ðDitë pune**ó është çdo ditë me përjashtim të ditëve që janë të përcaktuara si festa zyrtare dhe ditës së shtunë dhe të diel;
- l) **ðInstruksionet e shlyerjes**ó është tërësia e të dhënave që si rregull përfshin vlerën nominale, yield-in, çmimin e blerjes, llogarinë e shlyerjes së cash-it, dhe llogarinë e shlyerjes së titullit;
- m) **ðKalendari i organizimit të ankandeve**ó është një set të dhënash që përfshin si rregull llojet e titujve që do të emetohen, shumën që do të shpallet, dhe ditën e emetimit;

- n) **“Kërkesa jo konkurruese** ó është kërkesa në të cilën shprehet vetëm shuma e titullit që kërkohet të blihet në ankandin e titujve;
- o) **“Kërkesa konkurruese** ó është kërkesa në të cilën shprehet shuma që kërkohet të blihet në ankand si dhe yieldi/marzhi;
- p) **ðKoha e organizimit të ankandit** ó është koha nga hapja e kërkesave në orën e përcaktuar në njoftimin e ankandit deri në momentin e dërgimit të informacionit mbi kërkesat nga Banka për Ministrinë;
- q) **ðKufiri ndarës i kërkesës konkurruese dhe jo konkurruese** ó është shuma maksimale e përcaktuar për pjesëmarrje jo konkurruese në një ankand për një pjesëmarrës;
- r) **“Kujdestar”** ó është banka e autorizuar nga Autoriteti për ofrimin e shërbimeve të kujdestarisë së titujve sipas përcaktimeve të Ligjit ðPër titujt;
- s) **ðKupon** ó është norma e interesit e përcaktuar për obligacionin në momentin e emetimit të tij;
- t) **ðLigji “Për titujt”** ó është Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008;
- u) **“Llogari shlyerje”** ó janë llogari në sistemet e pagesave;
- v) **“Marzhi”** ó është vlera shtesë në përqindje e aplikuar mbi interesin referencë në rastin e titujve me kupon të ndryshueshëm;
- w) **ðMarzhi reduktues** ó është përqindja e caktuar që i zbritet vlerës së tregut të titullit. Kjo përqindje reflekton karakteristikat e letrës me vlerë, të tillë si maturimi i mbetur, rreziku i kreditit të emetuesit, likuiditeti i titullit. Marzhi reduktues përcaktohet nga Banka në rregulloret e saj për vlerësimin e titujve;
- x) **ðMjetet e komunikimit** ó janë televizionet kombëtare, gazetatat, faqet e internetit, sistemi i komunikimit REUTERS, Bloomberg, etj;
- y) **ðMjaftueshmëri e gjendjes së llogarisë** ó është vlerësim për llogarinë, kur kjo ka gjendje, e cila është e barabartë, ose më e madhe se vlera nominale e titullit që kërkohet të blihet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës në ankand;
- z) **ðNorma e riblerjes** ó është norma e interesit e përcaktuar nga palët në një marrëveshje riblerjeje ose të anasjelltë riblerjeje, me të cilën do të riblihen letrat me vlerë. Ky interes shprehet në përqindje në bazë vjetore, dy shifra pas presjes dhjetore;
- aa) **ðPeriudha e faljes** ó është periudha deri në të cilën ruhet pozicionin neto i krijuar nga një shlyerje në të njëjtën ditë të maturimeve dhe emetimeve të titujve. Periudha e faljes shprehet në ditë dhe ndodh midis datës së shlyerjes dhe datës së shlyerjes finale;

- bb) **“Pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në sistemet e pagesave”** - janë subjekte që kryejnë pagesat direkt nga llogaritë e tyre të shlyerjes pranë Bankës;
- cc) **“Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në ankand”** ó *janë pjesëmarrësit, të cilët janë miratuar nga Autoriteti dhe Ministria për të marrë pjesë drejtpërdrejtë në ankand me kërkesa për llogarinë vetiake dhe/ose për klientët e tyre¹”;*
- dd) **“Pjesëmarrës i tërthortë në sistemin e pagesave”** ó janë subjekte që kryejnë pagesat nëpërmjet agjentit shlyerës që është Banka;
- ee) **“Proratëo”** ó është raporti i sasisë së mbetur deri në plotësimin e shumës së shpallur me shumën e kërkesave me të njëjtin yield;
- ff) **“Regjistrar”** ó është shoqëria aksionere e licencuar nga Autoriteti, që ka për objekt të veprimtarisë organizimin dhe administrimin e të dhënave për titujt;
- gg) **“Rreziku operacionalo”** ó është rreziku i dështimit të kryerjes së procedurave/operacioneve për shkak të gabimit njerëzor;
- hh) **“Sistemi AIPS ” (Albanian Interbank Payment System)** ó është sistemi i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe. Ky është sistem i shlyerjes bruto në kohë reale të urdhërpagesave në lekë, me rëndësi sistematike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar;
- ii) **“Sistemi AFISaR”** ó (Albanian Financial Instrument Settlement and Registration) - është sistemi qendror i regjistrimit dhe i shlyerjes të titujve të shtetit shqiptar dhe titujve që mund të emetojë Banka;
- jj) **“Sistemet e pagesave”** ó janë sistemet AIPS dhe AFISaR që operohen nga Banka;
- kk) **“Sportelet”** ó janë njësi organizative të Bankës, të cilat kanë për detyrë kryesore ofrimin e shërbimit për pjesëmarrjen e individëve në ankandet për emetimin e bonove të thesarit;
- ll) **“Shoqëri komisionere”** ó është shoqëri aksionere me seli në Republikën e Shqipërisë, e licencuar nga Autoriteti të kryejë transaksione me titujt në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Ligjin për titujt;
- mm) **“Tituj”** - janë vetëm titujt e shtetit shqiptar dhe konkretisht: bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore të emetuara nga Ministria e Financave në përputhje me ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; ligjin nr. 9879, datë 21.02.2008 për titujt, si dhe aktet nënligjore;

¹ Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

- nn) **Tregu**” - është hapësira fizike ose funksionale ku blerësit dhe shitësit ndërveprojnë (direkt ose nëpërmjet ndërmjetësve) për shitblerjen e titujve;
- oo) **“Treg primar”** ó është hapësira fizike ose funksionale në të cilin Shteti Shqiptar emeton për herë të parë titujt. Ankandet e tregut primar të titujve shtetërorë organizohen nga Banka;
- pp) **“Treg sekondar”** - është hapësira fizike ose funksionale ku kryhen transaksionet me titujt, pasi ato janë emetuar së pari në tregun primar;
- qq) **Yieldö** ó është norma e kthimit nga investimi në tituj;
- rr) **öYield i ponderuarö** ó është yield-i mesatar i llogaritur nga yield-et e kërkesave konkurruese të pranuar në bazë të peshës individuale që kanë këto kërkesa në totalin e kërkesave konkurruese të pranuar në ankand;
- ss) **öVlera më e vogël e titullitö** ó është vlera nominale më e vogël që një titull mund të shitet (emetohet) ose të blihet sipas përcaktimeve në udhëzimet e Ministrit të Financave;
- tt) **öVlera minimaleö** ó është vlera më e vogël nominale sipas përcaktimeve në udhëzimet e Ministrit të Financave e vlefshme për pjesëmarrje në ankand.
- uu) **öHuadhënia e titujveö** - është marrëveshja midis dy palëve ku huadhënësi i kalon përkohësisht pronësinë e titullit huamarrësit përkundrejt vendosjes së kolateralit nga huamarrësi. Kushtet, afatet, interesat, tarifat dhe lloji i kolateralit përcaktohet në marrëveshje midis huadhënësit dhe huamarrësit.²
- vv) **öLlogari tranzitore e qeverisëö** ó është llogaria e hapur me qëllim kryerjen e shlyerjeve të detajuara, rezultati neto i të cilave reflektohet në llogarinë kryesore në lekë.³
- xx) **öTitull benchmarkö** ó – është emetimi më i fundit i shtetit shqiptar për një maturitet të caktuar. Titulli referencë (benchmark) mund të rihapet periodikisht deri në arritjen e një madhësie të paracaktuar nga Ministria. Vlerësimi i titullit referencë (benchmark) përdoret si pikë referimi për vlerësimin e titujve e tjerë shtetërorë me karakteristika të ngjashme në maturitet, shumën e emetimit dhe normën e kuponit.⁴
- yy) **öAnkandet e shkëmbimitö** ó janë ankande nëpërmjet të cilave emetuesi fton investitorët të shkëmbejnë një/disa tituj për një/disa tituj të tjerë.⁵

² Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

³ Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

⁴ Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

⁵ Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

Kreu II
Pjesëmarrja e Ministrisë në sistemin AFISaR

Neni 4
Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë

1. Ministria është pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në sistemin AFISaR të Bankës.
2. Aksesit në sistemin AFISaR i jepet Ministrisë nëpërmjet aksesit në rrjetin VPN të Bankës.
3. Administrimi i përdoruesve të Ministrisë në sistemin AFISaR bëhet nga Banka, pas kërkesës me shkresë zyrtare të sjellë nga Ministria.

Neni 5
Llogaritë e Ministrisë në sistem

Llogaritë e Ministrisë në sistemin AFISaR janë:

- a) Llogaria e emetuesit, që është llogaria në të cilën depozitohen titujt e emetuar prej Ministrisë. Kjo llogari shërben në ditët e shlyerjes së titujve, kur titujt kalojnë nga kjo llogari në llogarinë e pjesëmarrësve në ankand, të cilët janë shpallur fitues. Në ditën e maturimit, procesi i shlyerjes përfshin kalimin e titujve të maturuar nga llogaria e pjesëmarrësve në llogarinë e emetuesit dhe më pas titulli del nga qarkullimi.
- b) Llogaria vetjake, në të cilën depozitohen titujt që Ministria rezervon për veten nga një titull në momentin që ky emetohet. Titujt që janë në këtë llogari nuk janë pjesë e emetimit publik. Ato bëhen pjesë e emetimit publik në momentin që tregtohen nga Ministria në tregun sekondar të titujve.

Neni 6
Të drejtat e Ministrisë në sistemin AFISaR

1. Në sistemin AFISaR, Ministria ka të drejtat e mëposhtme:
 - a) të monitorojë gjendjen e llogarive të saj në çdo kohë;
 - b) të reflektojë vendimin për yieldin minimal/maksimal në ankandet për emetimin e titujve apo në ankandet e zhvilluara në tregun sekondar të titujve;
 - c) të aksesojë raportet mbi rezultatet e ankandëve dhe raportet të tjera sipas nenit 24.

2. Ministria autorizon Bankën të veprojë në emër të saj për shlyerjen e veprimeve të saj me titujt në tregun sekondar të titujve të dakorduar jashtë sistemit AFISaR, të tilla si:
 - a) marrëveshje riblerje dhe të anasjellta riblerjeje të titujve të lidhura nëpërmjet transaksioneve dypalëshe;
 - b) blerje/shitje të titujve të dakorduara nëpërmjet transaksioneve dypalëshe;
 - c) marrëveshje kolaterali financiar të lidhura nëpërmjet transaksioneve dypalëshe.

Neni 7

Përgjegjësitë për aspekte teknike të sistemit

1. Ministria në aksesimin e sistemit AFISaR ka përgjegjësitë e mëposhtme:
 - a) Të sigurojë rrjetin VPN për aksesimin dhe monitorimin e sistemit AFISaR;
 - b) Të marrë të gjitha masat, në mënyrë që vetëm personat e autorizuar të kenë akses në sistemin AFISaR dhe në pajisjet e sigurisë të tij;
 - c) Të administrojë procedurat dhe pajisjet e sigurisë që përdoren për garantimin e sigurisë për aksesimin e sistemit AFISaR.
2. Në aksesimin e sistemit AFISaR, Banka ka të gjitha përgjegjësit kundrejt Ministrisë si kundrejt të gjithë pjesëmarrësve të tjerë të drejtpërdrejtë, të përcaktuara në rregulloren e Bankës për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)ö.
3. Banka administron përdoruesit e Ministrisë në sistemin AFISaR pas sjelljes së kërkesës me shkresë zyrtare nga Ministria.
4. Aspektet e tjera teknike të pjesëmarrjes së Ministrisë në sistemin AFISaR janë të zbatueshme sipas Aneksit 6, pjesë përbërëse e marrëveshjes.

Kreu III

Organizimi i ankandit për emetimin e titujve

Neni 8

Komisioni i ankandit

1. Komisioni i ankandit ka për detyrë kryerjen e procedurave për organizimin e ankandit. Ai përbëhet nga dy përfaqësues punonjës së Bankës, dhe një përfaqësues punonjës i Ministrisë.

2. Banka dhe Ministria informojnë njëra - tjetrën, nëpërmjet shkresës zyrtare, për anëtarët e zgjedhur të komisionit.
3. Komisioni duhet të ruajë në çdo kohë paanshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit që posedon gjatë zhvillimit të ankandit duke respektuar rregullat për shpërndarjen e informacionit.

Neni 9 Përgjegjësitë e Ministrisë

Në procesin e organizimit të ankandit, Ministria ka përgjegjësitë e mëposhtme:

1. T \ddot{a} dërgojë Bankës kalendarin e organizimit të ankandeve përgjatë një tremujori. Kalendarin dërgohet në mënyrë elektronike dhe shkresore jo më vonë se dy javë përpara fillimit të tremujorit dhe sa herë që kalendarin ndryshohet sipas nevojave të Ministrisë.
2. Ministria, në përputhje me politikat e saj për administrimin e borxhit, ka të drejtë t \ddot{a} kërkojë Bankës, organizimin e ankandeve të paparashikuara në programin kohor. Këto ankande quhen ankande të jashtëzakonshme.
3. T \ddot{a} dërgojë Bankës njoftimin e detajuar për organizimin e ankandeve jo më vonë se dy ditë punë përpara ditës së zhvillimit të ankandit. Njoftimi dërgohet me shkresë zyrtare dhe në mënyrë elektronike, sipas nenit 11, pika 2.
4. Të kujdeset që ditët e organizimit të ankandit dhe ditët e emetimit të jenë ditë pune.
5. Në rastin e rihapjes së ankandit, njoftimi për organizimin e rihapjes duhet të dërgohet të paktën tre (3) orë para rihapjes së tij.
6. Të publikojë kalendarin dhe njoftimin e organizimit të ankandeve në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave.
7. Të marrë vendimin mbi yield-in/marzhin maksimal të pranuar për secilin titull.

Neni 10 Përgjegjësitë e Bankës

Në procesin e organizimit të ankandit, Banka ka përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Të sigurojë teknologjinë e përshtatshme për organizimin e ankandeve, duke respektuar minimizimin e rrezikut operacional dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

2. Të sigurojë mbarëvajtjen e organizimit të ankandit duke respektuar shkëmbimin e informacionit me Ministrinë dhe tregun në kohën e përcaktuar.
3. Të sigurojë respektimin e kushteve për të marrë pjesë në ankand nga individët, për të cilët ofron aksesin për pjesëmarrjen në ankand nëpërmjet sporteve të saj.
4. *Të publikojë në faqen e saj të internetit listën e pjesëmarrësve të përzgjedhur nga Ministria për pjesëmarrje në ankandet e titujve referencë (benchmark).*⁶

Neni 11

Njoftimi i ankandit

1. *Si rregull, Banka çel ankandin në sistemin AFISaR, sipas të dhënave, përfshirë edhe vlerën nominale, që janë përcaktuar në kalendarin e shpallur tremujor të emetimit. Çelja e ankandit mund të ndodhë jo më vonë se 2 javë përpara datës së zhvillimit të ankandit. Banka, në varësi të kushteve specifike të emetimit mund të ulë afatin e çeljes së ankandit në sistem, por jo më vonë se 2 ditë para datës së zhvillimit të ankandit.*⁷
2. Ministria sjell njoftimin përfundimtar për zhvillimin ose jo të ankandit për emetimin e titullit, jo më vonë se 2 (dy) ditë pune përpara afatit të përcaktuar në pikën 3, shkronja e, të këtij neni. Për organizimin e ankandëve të jashtëzakonshme, Ministria duhet të njoftojë paraprakisht Bankën me shkresë zyrtare dhe në mënyrë elektronike, të paktën një ditë para zhvillimit të ankandit.
3. Njoftimi sipas pikës 2, për organizimin e ankandit i përcaktuar nga Ministria duhet të ketë si rregull detajet e mëposhtme:
 - a) llojin e titullit që do të emetohet;
 - b) vlerën nominale të titullit që do të shpallet për shitje për tregun dhe vlerën nominale të titullit që do të mbahet në llogarinë vetjake të Ministrisë nga ky emetim. Në rastet kur ky detaj nuk përcaktohet, atëherë pjesa e Ministrisë në emetim është 0.;
 - c) datën e emetimit të titullit. Si rregull data e emetimit është 2 (dy) ditë pune pas datës së zhvillimit të ankandit për titujt në lekë dhe 5 (pesë) ditë pune për titujt në valutë. Në rast të ankandëve të jashtëzakonshme mund të bëhet përjashtime nga rregulli i mësipërm kur një gjë e tillë është e mundur.;
 - d) datën e maturimit të titullit;
 - e) datën dhe orën kur përfundon afati i hedhjes së kërkesave nga pjesëmarrësit përveç Bankës;
 - f) është titull me kupon/ apo me zbritje;

⁶ Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

⁷ Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

- f/1) **norma e kuponit (në rast se është përcaktuar);**
 - g) kuponin indikativ (në rast se ka);
 - h) është me kupon fiks apo variabël (në rast se aplikohet);
 - i) datën e shlyerjes së veprimeve në rastin kur bëhet rihapje e ankandit;
 - j) monedhën;
 - k) pranohen kërkesa konkurruese, jo konkurruese apo të dyja. Në rast se ky detaj nuk është i përcaktuar atëherë në ankand mund të vijë kërkesa konkurruese dhe jo konkurruese.;
 - l) konvencioni i ditëve mbi të cilat llogaritet interesi, në rastet kur nuk është përcaktuar në udhëzimet e Ministrit të Financave;
 - m) mënyrën e përcaktimit të çmimit në ankand: ankand me shumë çmime apo ankand me çmim uniform, në rastet kur nuk është përcaktuar në udhëzimet e Ministrit të Financave;
 - n) datën e shlyerjes. Në rast se ky detaj nuk është i përcaktuar atëherë, data e shlyerjes është njësoj me datën e emetimit.;
 - o) datën e shlyerjes finale. Në rast se ky detaj nuk është i përcaktuar atëherë, data e shlyerjes finale është njësoj me datën e shlyerjes.
4. Në përputhje me synimet e saj, Ministria mund të përcaktojë edhe:
- a) intervalin e vlerave për kërkesat konkurruese;
 - b) intervalin e vlerave për kërkesat jo konkurruese;
 - c) vlerën maksimale konkurruese të lejuar.
 - d) **Intervalin e pranueshëm të yiled-eve.**⁸
- ~~5. Ministria mund ta kufizojë paraprakisht yield-in maksimal që synon të pranojë në ankand, duke ja njoftuar këtë Bankës. Ky informacion nuk i njoftohet tregut.~~
6. Banka përcakton numrin unik (ISIN) që do të ketë secili titull që do emetohet sipas rregullit të përcaktuar në Aneksin 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e marrëveshjes.

Neni 12 Pranimi i kërkesave

1. Çdo kërkesë e pranuar në ankand konsiderohet urdhër për kryerjen e veprimeve me llogaritë, që ka paraqitësi i kërkesës apo subjekti që ndërmjetëson pjesëmarrjen në ankand, në sistemet e pagesave të Bankës.

⁸ Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

2. Paraqitja e kërkesave në ankand për subjektet juridike kryhet si më poshtë:
 - a) nëpërmjet sistemit AFISaR nëse janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të tij;
 - b) nëpërmjet pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë, me të cilët kanë kontratë për llogarinë e titullit.
 - i) Në rastet kur subjekti ka kontratë për llogarinë e titullit me Bankën, por llogarinë e fondeve e ka me një agjent shlyerës të ndryshëm nga Banka, subjekti duhet të paraqesë kërkesën sipas Aneksit 2 dhe vërtetimin nga agjenti shlyerës sipas formatit në Aneksin 3.
 - ii) Në rastet kur subjekti ka kontratë për llogarinë e titullit me Bankën dhe ka edhe llogari të fondeve në sistemin AIPS/Loro të Bankës, atëherë anëtarët e Bankës në Komisionin e Ankandit, duhet të vërtetojnë mjaftueshmërinë e gjendjes së llogarisë së subjekteve, në sistemin AIPS në ditën e ankandit.
 - c) nëpërmjet Bankës, kur ky subjekt ka kontratë për llogarinë e titullit me një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë të ndryshëm nga Banka. Kërkesa për pjesëmarrje në ankand mund të paraqitet në Bankë vetëm nëse ajo është 100 milionë leke ose vlerën ekuivalente në valute e konvertuar me kursin e këmbimit të shpallur nga Banka një ditë përpara ankandit. ajo
3. Paraqitja e kërkesave në ankand për personat fizikë kryhet nëpërmjet pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë me të cilin personat fizikë kanë kontratë për llogarinë e titullit.
4. Të gjithë kërkesat duhet të jenë në sistemin AFISaR, ose të jenë paraqitur pranë Bankës në formë shkresorë sipas pikës 2, shkronja b dhe c, deri në orën e shpallur në njoftimin e ankandit.
5. Për arsye të mirë argumentuara, Ministria mund t'i kërkojë Bankës shtyrjen e afatit për pranimin e kërkesave të tregut të njoftuar sipas pikës 3, shkronja e. Banka mund ta pranojë shtyrjen në rast se nuk preket parimi i trajtimit njësoj të të gjithë pjesëmarrësve. Shtyrja e afatit nuk mund të ndodhë pas realizimit të ekzekutimit të ankandit.
6. Kërkesa e Bankës për pjesëmarrje në ankand për llogarinë vetjake të saj është gjithmonë jokonkurrese dhe vjen e para në renditje e kërkesave për t'u pranuar. Shuma e kërkuar për pjesëmarrje të Bankës në ankand, nuk duhet të jetë më e lartë se shumata që maturohet.

Neni 13
Zhvillimi i ankandit

1. Kërkesat e ardhura në mënyrë shkresore, evidentohen në një regjistër të veçantë nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Ato hapen në afatin e përcaktuar në njoftimin e ankandit ose të ndryshuar sipas nenit 12 pika 5, në prani të gjithë anëtarëve të Komisionit. Anëtarët e Bankës në Komisionin e Ankandit hedhin të gjitha kërkesat që janë në formë shkresore në sistemin AFISaR, si rregull jo më vonë se një orë mbas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e ankandit. Në rast se ka arsye të mirë argumentuara, Banka dhe Ministria vendosin për shtyrjen e kësaj kohe.
2. Komisioni si rregull refuzon:
 - a) kërkesat që nuk kanë vërtetimin sipas nenit 12, pika 2, shkronja b/i;
 - b) kërkesat me yield-in më të lartë, në rast se në ankand paraqiten kërkesa më shumë se numri i lejuar i përcaktuar nga Ministria në aktet rregullative të saj;
 - c) kërkesat që nuk janë sipas përcaktimeve të Ministrisë në aktet rregullative të saj për vlerën minimale, apo për kufirin ndarës të kërkesës konkurruese dhe jo konkurruese; dhe
 - d) kërkesat që nuk janë të qarta për shumën dhe/ose yield-in e përcaktuar.
3. Përjashtim nga pika 3, shkronjat öcö dhe ödö, mund të bëjnë rastet kur gjykohet në mënyrë unanime nga Komisioni që është gabim njerëzor i paqëllimtë. Në këtë rast, Komisioni merr konfirmimin e paraqitësit të kërkesës dhe e pranon atë me vendim unanim vetëm në rast se është korrigjim i gabimit njerëzor. Në rast të pamundësisë së marrjes së konfirmimit brenda kohës së organizimit të ankandit, kërkesa refuzohet.
4. Për kërkesat, vlera nominale e të cilave është e përcaktuar në kundërshtim me shumëfishin e vlerës më të vogël të përcaktuar nga Ministria në aktet e saj rregullative, Komisioni ka të drejtë ta rrumbullakosë shumën në përputhje me kriterin e shumëfishit të përcaktuar. Ky ndryshim i kërkesës i komunikohet paraqitësit të saj.
5. Për kërkesat e paraqitura nga subjektet juridike sipas nenit 12, pika 2, shkronjës öbö, paragrafi öiöö , vlera e të cilave është më e lartë se gjendja e fondeve në llogarinë e pjesëmarrësit, Komisioni ka të drejtë të pranojë shumën më të vogël sipas gjendjes së llogarisë duke e rrumbullakosur sipas kriterit të shumëfishit të vlerës më të vogël.
6. Për çdo refuzim kërkesë, Komisioni duhet të njoftojë me shkrim paraqitësin e kërkesës duke shpjeguar arsyet e refuzimit.
7. Kërkesat jo konkurruese të hedhura në sistemin AFISaR konsiderohen të rregullta në çdo kohë.
8. Ankandi quhet i vlefshëm kur paraqitet të paktën një kërkesë. Në rast të mungesës së kërkesave konkurruese, kërkesat jo konkurruese pranohen duke zbatuar yield-in e përcaktuar në ankandin më të fundit të zhvilluar për të njëjtin lloj titulli.
9. Në përfundim të procesit të regjistrimit të të gjitha kërkesave, Komisioni harton dhe nënshkruan një procesverbal ku evidentohen si rregull numri i kërkesave të paraqitura,

numri i kërkesave të refuzuara, arsyet e refuzimit dhe shuma totale. Procesverbali mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera sipas gjykimit të Komisionit.

Neni 14 **Nxjerrja e rezultatit të ankandit**

1. Pas regjistrimit të kërkesave, Banka njofton Ministrinë për aksesimin e informacionit mbi ankandin në sistemin AFISaR.
2. Ministria reflekton vendimin e marrë mbi yield-in maksimal të pranuar në sistemin AFISaR brenda ditës që zhvillohet ankand, por jo më vonë se oraret e përcaktuara në rregulloren e sistemit AFISaR.
3. Ky informacion dërgohet në rrugë elektronike dhe konfirmohet edhe me shkresë zyrtare.
4. Pas marrjes së informacionit sipas pikës 2, Banka bën të gjitha hapat për realizimin e procesit të ekzekutimit të ankandin.
5. Banka njofton tregun për rezultatin e ankandit. Njoftimi shpallet si rregull në faqen e internetit të Bankës dhe/ose në sistemin Reuters. Njoftimi përmban si rregull të dhënat e mëposhtme:
 - a) shumën e shpallur për shitje për titullin (titujt) sipas njoftimit të ankandit;
 - b) shumën e ofruar nga pjesëmarrësit për titullin (titujt) në ankand;
 - c) shumën e pranuar nga Ministria për secilin titull (titujt);
 - d) numrin total të kërkesave konkurruese të ofruara;
 - e) numrin total të kërkesave konkurruese të pranuar;
 - f) datën e zhvillimit të ankandit;
 - g) datën e emetimit të titullit (titujve);
 - h) datën e maturimit të titullit (titujve);
 - i) yield-i (marzhi) minimal kërkuar/pranuar;
 - j) yield-i (marzhi) maksimal kërkuar/pranuar;
 - k) yieldin e ponderuar (në rast se ka);
 - l) kuponin (në rast se ka);
 - m) frekuencën e pagesës së kuponit (në rast se ka); dhe
 - n) proratën e kërkesave konkurruese dhe kërkesave jo konkurruese.
6. Ministria dhe pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë aksesojnë direkt në sistemin AFISaR informacionin mbi rezultatet e ankandit dhe raportin përfundimtar të ankandit ku për çdo subjekt fitues, jepen në mënyrë të detajuara:
 - a) shumat e pranuar;
 - b) *yield*-i me të cilin kanë konkurruar; si dhe
 - c) çmimi i blerjes që rezulton nga këto të dhëna.

7. Banka pajis individët që marrin pjesë në ankand nëpërmjet sporteleve të saj me vërtetim shpallje fitues. Ky vërtetim përmban logon e Bankës dhe atë të Ministrisë.

Neni 15

Konvencionet për llogaritjet e çmimeve në tregun primar

1. Yieldi i mesatar i ponderuar përcaktohet me 3 (tre) shifra pas presjes dhjetore.
2. Çmimi i titullit për vlerën më të vogël të tregtuar do të përcaktohet me 6 (gjashtë) shifra pas presjes dhjetore.
3. Për titujt me kupon të ndryshueshëm, për llogaritjen e indeksit do të merren yield-et e ponderuar të 3 (tre) ankandeve më të fundit me datë zhvillimi përpara datës së zhvillimit të ankandit për titullin me kupon të ndryshueshëm.
4. Përcaktimi i indeksit për riçmimin e kuponit për titujt e ndryshueshëm, do të kryhet automatikisht në sistemin AFISaR duke marrë të dhënat për yield-et mesatare të ponderuara të 3 (tre) ankandeve me datë zhvillimi përpara ditës së llogaritjes së kuponave. Indeksi përcaktohet me 4 (katër) shifra pas presjes dhjetore.

Kreu V

Veprimet e Ministrisë në tregun sekondar të titujve

Neni 16

Thirrja e titujve

1. Ministria ka të drejtë të bëjë thirrje të titujve vetëm në rast se një gjë e tillë është parashikuar që në të dhënat e përgjithshme të ankandit ose në prospektin e titullit të regjistruar në sistemin AFISaR dhe data e thirrjes është përcaktuar në marrëveshje me të gjithë zotëruesit e letrës.
2. Ministria përcakton çmimin e thirrjes së titujve, dhe njofton Bankën.
3. Veprimet e Bankës në një rast të thirrjes së titullit nga Ministria janë të ngjashme sikundër një maturim i zakonshëm. Ndryshim përbën data dhe çmimi të përcaktuara sipas pikës 1 dhe

Neni 17

Ankandi për blerjen mbrapsht të titullit

1. Ministria në përputhje me synimet e saj i kërkon Bankës organizimin e ankandit për blerjen mbrapsht të titullit të emetuar prej saj që janë ende të pamaturuar.

2. Ministria i dërgon Bankës njoftimin për ankandin për blerjen mbrapsht të titullit. Njoftimi përmban si rregull detajet e mëposhtme:
 - a) numrin unik (ISIN) të titullit që do blihet mbrapsht;
 - b) datën e shlyerjes së ankandit;
 - c) mënyrën e përcaktimit të çmimit në ankand: ankand me shumë çmime apo ankand me çmim uniform.
3. Në ankand mund të marrin pjesë të gjithë mbajtësit e letrës, të cilët shprehin vullnetin e tyre për të marrë pjesë nëpërmjet pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë shumën që do marrin pjesë dhe yield-in.
4. Ministria merr vendimin mbi yield-in minimal/maksimal të pranuar dhe e reflekton këtë vendim në sistemin AFISaR.
5. Banka ekzekuton ankandin dhe pjesëmarrësit njoftohen për rezultatet nëpërmjet sistemit AFISaR.
6. Shlyerja e transaksioneve të gjeneruara nga ky ankand bëhet në përputhje me shlyerjen e transaksioneve të shitjes të përcaktuara në rregulloren e Bankës për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)ö.

Neni 18

Ankand për marrëveshje riblerjeje/të anasjellta riblerjes së titujve

1. Ministria mund të kërkojë Bankës organizimin e ankandit për lidhjen e marrëveshjeve të riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve.
2. Banka vlerëson impaktin që mund të ketë organizimi i këtyre ankandëve në operacionet e saj të tregut të hapur për zbatimin e politikës monetare dhe i kthen përgjigje Ministrisë.
3. Ankandet e marrëveshjeve të riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të titujve në sistemin AFISaR mund të organizohen vetëm në monedhën ALL. Në këto ankande marrin pjesë vetëm bankat tregtare për llogari të tyre.
4. Në qoftë se palët bien dakord për organizimin e ankandit, Ministria i dërgon Bankës njoftimin për ankand. Njoftimi duhet të përmbajë si rregull:
 - a) detajet e mëposhtme:
 - i. llojin e ankandit (marrëveshje riblerjeje apo marrëveshje e anasjelltë riblerjeje);
 - ii. shumën sipas specifikimeve të llojit të ankandit;
 - iii. datën dhe orën e kur përfundon afati i hedhjes së kërkesave;

- iv. datën e shlyerjes së marrëveshjes;
 - v. datën e maturimit të marrëveshjes;
 - vi. mënyrën e përcaktimit të çmimit në ankand: ankand me shumë çmime apo ankand me çmim uniform.
- b) në rast se Ministria ka pritje për normën e riblerjes, ajo mund të njoftojë edhe normën minimale/maksimale të riblerjes.

Neni 19

Ankand për marrëveshje riblerjeje

1. Nëpërmjet ankandit të marrëveshjeve të riblerjes, Ministria synon huamarrjen e likuiditetit nga tregu për një periudhë më të shkurtër se (3) tre muaj.
2. Ministria përdor titujt që janë në llogarinë e saj vetjake në AFISaR në ankandet për marrëveshjet e riblerjes.
3. Titujt që do përdoren duhet të kenë datë maturimi më të largët se data e maturimit të marrëveshjes së riblerjes.
4. Krahas të dhënave të përcaktuara për njoftimin e ankandit sipas nenit 18, pika 4, Ministria përcakton titujt që do përdoren në ankandin e marrëveshjeve të riblerjes, duke i njoftuar Bankës kodin ISIN të tyre.
5. Shuma e shpallur në ankand përcaktohet në vlerë nominale. Vlera ekuivalente e likuiditetit për shumën e shpallur në vlerë nominale llogaritet bazuar në vlerën ditore të titujve që renditen sipas pikës 6 dhe në marzhin reduktues të secilit sipas formulës në Aneksin 5.
6. Në rast se Ministria sipas pikës 4 përcakton më shumë se një titull, përzgjedhja e titujve për llogaritjen e vlerës ekuivalente të likuiditetit:
 - a) bonot e thesarit ezaurohen të parat;
 - b) bonot e thesarit me vlerë nominale më të lartë ezaurohen të parat;
 - c) më pas obligacionet me vlerë nominale më të lartë;
 - d) në rast se ka konflikt në rregullat për shembull dy bono thesari me të njëjtën vlerë; nominale, titulli zgjidhet sipas rendit alfabetik të ISIN-it të tyre.
7. Banka njofton Ministrinë për vlerën ekuivalente të likuiditetit të llogaritur që i korrespondon shumës së shpallur në vlerë nominale e përlllogaritur sipas pikave 5 dhe 6. Në rast se Ministria është dakord, Banka shpall njoftimin për ankandin e marrëveshjeve të riblerjes në sistemin AFISaR. Në rast se Ministria kërkon ta ndryshojë shumën, bashkëpunon me Bankën për përzgjedhjen e titujve që janë më afër shumës së synuar nga Ministria për të huamarrë nga tregu.

8. Në ankandin e marrëveshjeve të riblerjes, bankat i paraqesin kërkesat në sistemin AFISaR duke përcaktuar shumën që do t'ia japin hua Ministrisë dhe normën e riblerjes.
9. Kërkesat e bankave pranohen duke filluar nga norma e riblerjes më e ulët deri në plotësimin e vlerës ekuivalente të likuiditetit të shpallur nga Ministria.
10. Vendimi përfundimtar për normën maksimale të riblerjes përcaktohet nga Ministria, e cila e paraqit këtë vendim në sistemin AFISaR.
11. Banka ekzekuton ankandin e marrëveshjeve të riblerjes. Bankat aksesojnë drejtpërdrejtë në sistemin AFISaR rezultatet e ankandit.
12. Shlyerja e transaksioneve të gjeneruara nga ky ankand bëhet në përputhje me shlyerjen e marrëveshjeve të riblerjes të përshkruara në rregulloren e Bankës òPër funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)ò

Neni 20

Ankand për marrëveshje të anasjelltë riblerjeje

1. Nëpërmjet ankandit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes, Ministria synon huadhënien e likuiditetit nga tregu për një periudhë më të shkurtër se (3) tre muaj.
2. Shuma e shpallur për huadhënie nëpërmjet ankandit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes e njoftuar nga Ministria sipas nenit 18, pika 4 është e shprehur në vlerë ekuivalente të likuiditetit.
3. Ministria pranon titujt që vendosin bankat në një ankand për marrëveshjet e anasjellta të riblerjes së titujve. Bankat mund të zgjedhin shumë tituj në përputhje me synimin që kanë për shumën që duan të marrin pjesë në ankand. Titujt e përzgjedhur nga bankat vlerësohen nga sistemi në përputhje me formulën e përcaktuar në Aneksin 5, në mënyrë që vlera nominale e titujve të mbulojë shumën që bankat synojnë të huamarrin nga Ministria.
4. Kërkesat e bankave pranohen duke filluar nga norma e riblerjes më e lartë deri në plotësimin e vlerës ekuivalente të likuiditetit të shpallur nga Ministria.
5. Përcaktimet në nenin 19, pikat 10, 11, 12 janë të njëjta edhe në rastin e ankandit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes.

Neni 20/1

Huadhënia e titujve referencë (*benchmark*)

1. òMinistria ka të drejtë t'u ofrojë pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë të përzgjedhur, huadhënien e titujve që ka të rezervuar në llogarinë vetjake. Kushtet për realizimin e

hudhënies përcaktohen në kontratën e lidhur midis Ministrisë dhe pjesëmarrësve të përzgjedhur nga ajo.

- 2. Veprimet me pjesëmarrësit në bazë të kushteve të përcaktuara sipas pikës 1 dhe reflektimi i tyre në sistemin AFISaR në përputhje me nenin 6, pika 2, realizohen nga Banka.*
- 3. Banka njofton elektronikisht Ministrinë për veprimet e kryera në bazë ditore.⁹*

Neni 20/2 **Ankandet e shkëmbimit**

Ministria mund t'i kërkojë Bankës organizimin e ankandëve të shkëmbimit duke përcaktuar titujt që do shkëmbehen si dhe të dhëna të tjera të nevojshme sipas përcaktimit në Nenin 11.¹⁰

Kreu VI **Shlyerja e veprimeve**

Neni 21 **Shlyerja e veprimeve me tituj dhe Regjistri i titujve**

1. Në sistemin AFISaR shlyhen të gjitha veprimet me titujt e emetuara nga Ministria për të cilët ankandi zhvillohet nga Banka në këtë sistem.
2. Përgjegjësitë e Bankës janë:
 - a) të sigurojë teknologjinë e informacionit, bazën rregullative dhe burimet njerëzore për realizimin e shlyerjes së transaksioneve që lidhen me titujt për të cilat realizon ankandin;
 - b) të dërgojë instruksionet e shlyerjes së veprimeve të ankandit;
 - c) të dërgojë instruksionet e shlyerjes të maturimit të titujve;
 - d) të dërgojë instruksionet e shlyerjes për pagesat e kuponave për të gjithë subjektet që kanë llogari në sistemin AFISaR; dhe
 - e) të derdhë në llogarinë e Ministrisë në Bankë, tatimin e mbajtur në burim për subjektet që marrin pjesë në ankand. Për të realizuar këtë proces, Banka mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ,ose të instruktohet nga ky autoritet nëpërmjet një shkrese zyrtare.

⁹ Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

¹⁰ Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

3. Shlyerja e transaksioneve në tregun primar bëhet në bazë bruto në llogaritë e titujve (transaksion për transaksion) dhe në bazë neto për fondet. Me shlyerjen në bazë neto të fondeve do të kuptohet që operacionet me tituj me të njëjtën datë shlyerje, ku përfshihen pagesat që gjenerohen nga maturimi i titujve, pagesat që gjenerohen nga emetimi i titujve dhe pagesat që gjenerohen nga rihapje e ankandit, do të netohen në një pagesë fondesh si për Ministrinë, ashtu edhe për mbajtësit e titujve që kanë llogari në sistemin AFISaR.
4. Banka dhe Ministria përcaktojnë periudhën e faljes gjatë të cilës transaksionet rrijnë në pozicion neto. Në rast të mungesës së përcaktimit të kësaj periudhe, kjo periudhë do të konsiderohet 0 (zero) ditë pune.
5. Në rast se transaksionet e tregut primar nuk shlyhen nga përfituesit e titullit në datën e shlyerjes, atëherë ato riciklohen deri në datën e shlyerjes finale, në rast se këto të dyja janë të ndryshme.
6. Në procesin e shlyerjes, Ministria dhe Banka:
 - a) rakordojnë pagesat e kuponave dhe të maturimit 3 (tre) ditë përpara datës së pagesës.
 - b) për pagesën e kuponave për titujt në ALL, veprohet në përputhje me marrëveshjen e lidhur ndërmjet palëve oPër komunikimin elektronik midis Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) dhe sistemeve të pagesave AIPS dhe AECH të Bankës-ö ndërsa për kuponat në valutë, Ministria urdhëron Bankën për marrjen e fondeve nga llogaria e saj në valutë në Bankë.
 - c) në rast se ka diferencë midis shumës së pagesave individuale të kuponave që paguhën për mbajtësit e titullit dhe vlerës së kuponit të rakorduar me Ministrinë, atëherë Banka kompeson/tërheq diferencat.

Neni 21/1¹¹
Shlyerja e titujve

1. *öBanka prek me iniciativën e saj llogarinë kryesore të Qeverisë në Lekë, në çdo rast, për rezultatet neto të veprimeve me tituj të Ministrisë në tregun primar dhe në tregun sekondar.*
2. *Shlyerja e transaksioneve individuale të gjeneruara në AFISaR nga veprimet e Ministrisë në tregun primar apo në tregun sekondar kryhet nëpërmjet llogarisë tranzitore të shlyerjes.*

¹¹ Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

3. *Kur diferenca midis maturimit/emetimit për çdo ankand në ditën apo blerjeve/shitjeve në tregun sekondar në datën e shlyerjes është:*
 - a) *më e madhe se zero, prekja e llogarisë kryhet në fillim të ditës së punës;*
 - b) *më e vogël se zero prekja e llogarisë kryhet në mbarim të procesit të shlyerjes në llogarinë tranzitore, maksimalisht në fund të ditës së punës në datën e shlyerjes.*
4. *Kur për shkak të situatës së likuiditetit të krijuar nga përqendrimi i maturimit/blerjeve të titujve në një prej pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë krijohet pengesë në procesin e shlyerjes, Banka i kërkon Ministrisë transferimin e menjëhershëm të likuiditetit nga llogaria kryesore në llogarinë tranzitore. Kalimi i likuiditetit është i përkohshëm dhe realizohet në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për “Komunikimin elektronik midis sistemit informatik financiare të Qeverisë (SIFQ) dhe sistemeve të pagesave AIPS dhe AECH.*
5. *Pas zgjidhjes së situatës, Banka transferon likuiditetin e kaluar sipas pikës 4, nga llogaria tranzitore në llogarinë kryesore.*
6. *Në mungesë të likuiditetit në llogarinë kryesore të Qeverisë, zgjidhja e situatës kryhet nga Banka në përputhje me rregulloret e saj për sistemet AFISaR dhe AIPS.*

Neni 22

Përgjegjësia e Ministrisë për shlyerjen

Ministria në procesin e shlyerjes duhet të sigurojë likuiditetin e nevojshëm në ditën e maturimit të titujve dhe në ditën e pagesës së kuponave.

Neni 23

Mbajtja e regjistrit të titujve

1. Banka është përgjegjëse për mbajtjen e regjistrit në sistemin AFISaR për titujt, për të cilët organizon ankandin.
2. Mbajtësit e titujve të qeverisë në sistemin AFISaR dallohen si rregull në kategoritë e mëposhtme:
 - a) Banka;

- b) shoqëri tregtare;
 - c) fonde pensioni;
 - d) persona fizikë.
3. Banka do t'ja sigurojë Ministrisë së Financave detajim të mëtejshëm sipas kategorive më poshtë:
 - a) shoqëri sigurimi;
 - b) fonde investimi;
 - c) detajim në rezidentë dhe jo rezidentë;
 - d) të tjera.
 4. Personat juridikë/fizikë që nuk kanë llogari në sistemin e regjistrimit të titujve të Bankës, hapin llogari titull në subjektet e licencuara nga Autoriteti për të kryer veprimtari me titujt. Këto subjekte, kanë një llogari të veçantë në sistemin e regjistrimit të Bankës, nëpërmjet të cilës kryejnë veprimet për të gjithë personat juridikë/fizikë, për të cilët kanë hapur llogari titull në regjistrat e tyre.
 5. Banka duhet të sigurojë teknologjinë e duhur të informacionit për sigurinë e mbajtjes së të dhënave të regjistrimit të titujve.
 6. Regjistri i titujve në sistemin AFISaR duhet të evidentojë titujt, si rregull sipas detajeve respektive të tyre dhe sipas subjekteve që kanë llogari në këtë sistem.
 7. Banka bën regjistrimet përkatëse në regjistrin e titujve duke pasqyruar ngjarjet e mëposhtme:
 - a) emetimin dhe maturimin e titujve;
 - b) shitblerjet përfundimtare të titujve në tregun sekondar;
 - c) shitblerjet e përkohshme të titujve ndërmjet bankave dhe/ose me Bankën;
 - d) vendosjen e titujve si kolateral për veprimet ndërmjet bankave dhe/ose me Bankën.
 8. Banka është përgjegjëse për rakordimin e të dhënave që përmban regjistri në sistemin AFISaR me të dhënat e pjesëmarrësve që kanë llogari në këtë sistem.

Neni 24

Raportimi

Ministria akseson në sistemin AFISaR raportet e mëposhtme:

- a) raport mbi kërkesat në ankand të detajuar sipas pjesëmarrësve;
- b) raport përmbledhës mbi rezultatet e ankandit sipas pjesëmarrësve;
- c) të dhëna statistikore mbi ankandet;
- d) gjendjen e titujve sipas mbajtësve/pronarëve;
- e) raport mbi transaksionet me tituj;
- f) raport mbi pagesat e kuponëve.

Neni 24/1¹²
Llogaritja e fiksit të titujve referencë (benchmark)

Me kërkesë të Ministrisë, Banka mund të llogarisë dhe të publikojë në mjetet e saj të informimit, yield-in fiks të titujve referencë (benchmark) në bazë të kuotimeve të pjesëmarrësve të përzgjedhur nga Ministria gjatë intervalit kohor dhe sipas metodologjisë të dakorduar në kontratën e lidhur midis Ministrisë dhe këtyre pjesëmarrësve.

Neni 24/2¹³
Shkëmbimi i informacionit

Me kërkesë të Ministrisë, Banka vë në dispozicion të saj, në rast se është e mundur, informacionin e mëposhtëm:

- 1. Vlerësim për situatën financiare të kandidatëve për t'u përzgjedhur nga Ministria si pjesëmarrës në ankandet e titujve;*
- 2. Informacion mbi licencat e dhëna për kandidatët sipas përshkrimit në shkronjën "a";*
- 3. Informacion dhe/ose të dhëna nga sistemet që disponon në lidhje me tregtimin në tregun sekondar të titujve të pjesëmarrësve të përzgjedhur nga Ministria për emetimet në tregun primar të titujve;*

Neni 25
Të fundit

Për çdo çështje që nuk rregullohet në këtë marrëveshje, palët i referohen Marrëveshjes Kuadër.

Marrëveshja, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, ku secila nga palët mban 2 (dy) kopje.

Datë ____ . ____ .201

Datë ____ . ____ .201

¹² Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

¹³ Ndryshuar datë 06.07.2018, nr prot BSh 3632, nr prot MF 12971

Nr. Prot. _____

Për Bankën e Shqipërisë:

Nr. Prot. _____

Për Ministrinë e Financave:

Aneksi 4

Kodi unik i titujve (ISIN)

Kodi unik i titujve në sistemin AFISaR i referohet Kodit ISIN. Ky kod, deri në vendosjen e tij sipas standardeve ndërkombëtare të kodifikimit të titujve, përcaktohet nga Banka në përputhje me rregullin e mëposhtem. Ky kod përbëhet nga 12 karaktere të cilat mund të jenë vetëm shkronja kapitale ose numra. Si rregull, për letrat e emetuara nga qeveria, kodi do të përbëhet pjesët e mëposhtme:

- Kodi i vendit (AL)
- Për letrat në Euro shkronja E për të identifikuar monedhën e letrës (E)
- Numri i ankandit të emetimit fillestar të letrës (XXXX-me katër shifra për letrat në lekë me maturitet fillestar deri në 7 vjet; XXX-me tre shifra për ato në euro dhe për obligacionet në lekë me maturitet 10 vjet ose më të lartë)
- Lloji i letrës (TB-bono thesari; NF-obligacion me interes fiks; NV obligacion me interes variabël)
- Maturiteti i letrës (3M- bono thesari 3 mujore; 6M-bono thesari 6 mujore; 1Y-bono thesari 12 mujore; 2Y-obligacion 2 vjeçar; 3Y-obligacion 3 vjeçar; 5Y-obligacion 5 vjeçar; 10Y-obligacion 10 vjeçar)
- Dy shifrat e fundit të vitit të maturimit të letrës (yy)

Aneksi 5

Formula e llogaritjes së vlerës ekuivalente të likuiditetit për vlerën nominale në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes

$$Vlera = (1-H) * V_t * V_n$$

ku,

Vlera – i referohet vlerës ekuivalente të likuiditetit për vlerën nominale

H (marzhi reduktues) ó i referohet përqindjes së caktuar që i zbritet vlerës së tregut të titullit. Kjo përqindje reflekton karakteristikat e letrës me vlerë, të tillë si maturimi i mbetur, rreziku i kreditit të emetuesit, likuiditeti i titullit.

V_t (Vlera e tregut) ó është çmimi i llogaritur i titullit në bazë të yield-it të tregut të përlogaritur në mungesë të kuotimeve nga kurba e yield-eve dhe në bazë të formulës të përcaktimit të çmimit të njoftuar nga emetuesi ose në bazë të standardeve ndërkombëtare.

V_n (Vlera nominale) ó vlera nominale e titullit që do të përdoret për të garantuar kredinë brenda ditës.

Aneksi 6

1. Administrimi i ndryshimeve

- 1.1 Ndryshimet në sistemin AFISaR janë si më poshtë:
 - a) ndryshime funksionale dhe teknike të sistemit AFISaR;
 - b) ndryshime në SWIFNet FIN dhe në standardet SWIFT;
 - c) ndryshime në VPN.
- 1.2 Banka njofton dhe udhëzon Ministrinë para zbatimit të ndryshimeve të planifikuara të sistemit AFISaR, kur këto ndryshime ndikojnë tek Ministria.
- 1.3 Në rast ndryshimesh në operimin e sistemit AFISaR, lajmërohet paraprakisht Ministria, duke i dhënë kohën e nevojshme për t'u përgatitur si dhe për krijimin e kushteve të nevojshme për testimin e sistemit AFISaR.

2. Testimi i procedurave të Fallback-Recovery

- 2.1 Banka kryen çdo 6 muaj testimin e procedurave të saj të *Fallback-Recovery* për ngjarjet e paparashikuara në sistemin AFISaR.
- 2.2 Banka njofton Ministrinë për kalimin e operacioneve të sistemit AFISaR *primar* në sistemin AFISaR *backup*, për zhvillimin e testimit të procedurave të *Fallback-Recovery* si dhe për çdo veprim që ajo duhet të ndër marrë, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune para datës së testimit.
- 2.3 Për të aksesuar sistemin AFISaR *sekondar*, Ministria adresohet në *site-in backup* të sistemit AFISaR në Bankë nëpërmjet *webstation-it* të tyre.

3. Asistenca për përdoruesit në sistemin AFISaR

- 3.1 Banka ngre dhe mban një qendër për asistencën e përdoruesve të sistemit AFISaR, ku Ministria mund të adresohet për problemet e lidhura me të gjatë gjithë ditës së punës në këto sisteme.
- 3.2 Banka i dorëzon me e-mail Ministrisë informacionin për personat e kontaktit.
- 3.3 Banka, në vijim të paraqitjes së kërkesës me shkresë zyrtare nga Ministria krijon, modifikon dhe fshin përdoruesit e Ministrisë në sistemin AFISaR.

- 3.4 Për çdo kërkesë për pajisje sigurie, Ministria paraqet pranë Bankës formularin e paraqitur në shtojcën B bashkëlidhur këtij aneksi.
- 3.5 Për çdo kërkesë për ndryshim përdoruesish në VPN, Ministria paraqet pranë Bankës formularin e paraqitur në shtojcën C bashkëlidhur këtij aneksi.
- 3.6 Në rast pamundësie të modifikimit të fjalëkalimit të një përdoruesi, Ministria paraqet një kërkesë me shkresë zyrtare pranë Bankës.
- 3.7 Përdoruesit e Ministrisë kanë të drejta për reflektimin e vendimit mbi *yield-in* e pranuar në ankand si dhe monitorimi në sistemin AFISaR .
- 3.8 Në rast të fshirjes së një përdoruesi, Ministria sjell e-Token e tij për anulim pranë Bankës bashkëlidhur me një shkresë zyrtare.
- 3.9 Banka, çdo vit rinovon certifikatat dixhitale në e-Token të përdoruesve të Ministrisë, të paraqitura prej saj në Bankë, para apo pas përfundimit të afatit të skadencës, bashkëlidhur me një shkresë zyrtare nga Ministria.

4. Ngjarjet e paparashikuara dhe procedurat e emergjencës

4.1 Ngjarjet e paparashikuara

Ngjarjet e paparashikuara klasifikohen si më poshtë:

a) ngjarje të paparashikuara të sistemit AFISaR:

1. Banka administron situatat e emergjencës në sistemin AFISaR dhe merr masa për zgjidhjen e kësaj situatë në kohë.
2. Banka shpall situatën e emergjencës, në rast se brenda 30 (tridhjetë) minutave nuk zgjidhet problemi, si dhe njofton Ministrinë me e-mail /faks apo me telefon nëpërmjet personave të kontaktit për vazhdimin e operimit në sistem.
3. Banka njofton Ministrinë, menjëherë pas zgjidhjes së situatës së emergjencës, me e-mail /faks apo me telefon nëpërmjet personave të kontaktit për vazhdimin e operimit në sistem.
4. Banka, kur e gjykon të arsyeshme bën zhvendosjen në ambientin AFISaR *backup* dhe njofton Ministrinë.

b) ndërprerja e komunikimit pranë Ministrisë:

1. Nëse Ministria ndeshet me vështirësi teknike të cilat pengojnë operimin në sistemin AFISaR, njofton Bankën brenda 30 minutave nga momenti i konstatimit të këtyre vështirësive dhe merr masa për zgjidhjen e kësaj situatë në kohë.
 2. Banka, me marrjen e njoftimit nga Ministria, identifikon problemin dhe udhëzon Ministrinë për mundësi alternative.
 3. Ministria njofton Bankën, menjëherë pas zgjidhjes së situatës, me e-mail/faks apo me telefon nëpërmjet personave të kontaktit për vazhdimin e operimit në sistemin AFISaR.
- c) ngjarje të paparashikuara në rrjetin VPN.

Në rast defekti në linjën primare të internetit, vihet në funksionim linja *backup* e internetit.

4.2 Regjistrim i ngjarjeve të paparashikuara

Ministria regjistron të gjitha ngjarjet e paparashikuara dhe problemet e vërejtura në komunikimin me Bankën e Shqipërisë dhe i raporton ato pranë saj brenda 2 (dy) ditëve pune nga fundi i çdo muaji kalendarik sipas formatit të përcaktuar në shtojcën A bashkëlidhur këtij aneksi.

Shtojca A – Regjistrimi i ngjarjeve të paparashikuara.

Ministria e Financave për muajin _____ të vitit _____ në sistemin AFISaR

| Data e ngjarjes | Ora e ngjarjes | Natyra e problemit | Veprimi i ndërmarrë | Ora e rregullimit të problemit |
|------------------------|-----------------------|---------------------------|----------------------------|---------------------------------------|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

Dërgojeni këtë raport në fund të çdo muaji tek njësia që mbulon suportin e sistemit AFISaR pranë BSH.

Shtojca B – Formular për pajisje sigurie.



KONFIDENCIAL

**Banka e Shqipërisë
Departamenti i Operacioneve Monetare
Kërkesë për pajisje sigurie**

Tiranë, më / /

Për Bankën e Shqipërisë

Autorizuesi

()

_____ si pjesëmarrëse në sistemin AFISaR, ka nevojë për pajisje sigurie si më poshtë:

| Nr | Emri i pajisjes | Copë | Çmimi për njësi | Vlera |
|----|-----------------|------|-----------------|-------|
| 1 | | | | |
| 2 | | | | |

Emrat e personave(emër,mbiemër) që do të përdorin kartat:

| |
|--|
| |
| |
| |
| |
| |
| |

Për Institucionin Emetues:

Autorizuesi i kërkesës

Pajisjet e sigurisë u dorëzuan, sipas procesverbalit përkatës në datë:

Shtojca C – Formular për ndryshime në rrjetin VPN.

KONFIDENCIAL



FRM-SIG02

**Banka e Shqipërisë
Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
Kërkesë për ndryshime në rrjetin VPN**

Tiranë, më

.....

**Për Bankën e Shqipërisë
Autorizuesi**

Institucioni Emetues që paraqet kërkesën për ndryshime:

(_____)

Arsyeja dhe detaje për ndryshimet:

Për Institucionin Emetues:

Autorizuesi i kërkesës

(32)

